VENDIM
Nr. 311, datë 18.4.2013

PËR LEJIMIN E EKSPOZIMIT TË DISA OBJEKTEVE TË RRALLA ME VLERA UNIKE, NË KUADËR TË REALIZIMIT TË EKSPOZITËS "THESARE TË KULTURËS SHQIPTARE", NË PRISHTINË, KOSOVË, NGA DATA 20 PRILL 2013 DERI NË DATËN 21 GUSHT 2013

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e ekspozimit të disa objekteve të rralla me vlera unike, në kuadër të realizimit të ekspozitës "Thesare të kulturës shqiptare", në Prishtinë, Kosovë, nga data 20 prill 2013 deri në datën 21 gusht 2013, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ekspozimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të bëhet në përputhje me udhëzimin nr. 2, datë 18.3.2004 të Këshillit të Ministrave "Për lëvizjen e objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme, me vlera të veçanta kombëtare dhe unikale, për restaurimin, studimin dhe ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë".

3. Ngarkohen Instituti i Monumenteve të Kulturës "Gani Strazimiri" të kryejë shoqërimin dhe kthimin e ikonave në vendin e origjinës pas mbarimit të veprimtarisë dhe Qendra e Inventarizimit të Pasurive Kulturore të kryejë regjistrimin e lëvizjes së objekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha